

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 236, datë 18.2.2010, “PËR MARRJEN NË KONTROLL TË SHOQËRIVE ME OFERTË PUBLIKE”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 10 236, datë 18.2.2010, “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Ky ligj zbatohet për:

a) ofertat e shpallura publikisht për marrjen në zotërim të titujve me të drejtë vote, të emetuar nga shoqëri publike me seli në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në tregun e rregulluar në Shqipëri;

b) ofertat e shpallura publikisht për marrjen në zotërim të titujve me të drejtë vote, të emetuar nga shoqëri publike me seli në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, kur këta tituj janë të pranuar për tregtim në tregun e rregulluar të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 2

Në nenin 2, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën “gj”, pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

¹ Ky ligj është i përafuar plotësisht me:

Direktivën 2004/25/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 prillit 2004, lidhur me ofertat e marrjes në kontroll (takeover bids), FZ L 142, 30.4.2004, f. 12–23, CELEX: 32004L0025, ndryshuar kryesisht nga:

(i) Rregullorja (KE) nr. 219/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Mars 2009, FZ L 87, 31.03.2009 CELEX: 32009R0219 (ii) Direktiva 2014/59/BE (BRRD) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 maj 2014; FZ L 173, 12.06.2014; CELEX: 32014L0059; Neni 119; (iii) Rregullorja (BE) 2021/23 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 2020, mbi kornizën e rimëkëmbjes dhe rezolucionit të qendrave të kliringut, që ndër të tjera ndryshon Direktivën 2004/25/KE, FZ L 22, 22.1.2021, f. 1–102; dhe (iv) Direktiva (BE) 2023/2864 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2023, që ndryshon disa direktiva sa i përket krijimit dhe funksionimit të ESAP (përfshirë shtimin e nenit 16a në Direktivën 2004/25/KE), FZ L, 20.12.2023; CELEX: 32023L2864.

“Ofertat mund të jenë të detyrueshme ose vullnetare, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”

2. Pas shkronjës “n” shtohet shkronja “n/1” me këtë përmbajtje:

“n/1) “Tituj me votim të shumëfishtë” nënkuptojnë tituj të përfshirë në një klasë të veçantë dhe të ndarë, dhe që mbajnë më shumë se një votë secili.”

3. Pas shkronjës “o” shtohet shkronja “p” me këtë përmbajtje:

“p) “Shtetet Anëtare” janë shtetet e Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane.”

Neni 3

Në nenin 3, në shkronjën “d”, pas togfjalëshit “në interesin më të mirë të shoqërisë, si një e tërë” shtohet togfjalëshi “dhe nuk u mohon aksionarëve mundësinë për të vendosur mbi vlerën e ofertës”.

Neni 4

Në nenin 7, në pikën 1, pas shkronjës “j”, shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) Të dhëna të detajuara mbi mënyrën e pagesës së dëmshpërblimit për çdo humbje të shkaktuar si rezultat i zbatimit të normave nga Asambleja e Përgjithshme sipas nenit 17, pika 1, të ligjit dhe metoda e përdorur për përcaktimin e tij”

Neni 5

Në nenin 13, bëhen këto shtesa:

1. Në pikës 1, shtohet pika 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1 Nëse, pasi oferta bëhet publike dhe para se oferta të mbyllet për pranimin, ofertuesi ose ndonjë person që vepron në bashkëpunim me të, blen aksione të të njëjtit lloj apo kategori, me një çmim më të lartë se çmimi i ofertës, ofertuesi duhet të rrisë ofertën e tij/saj në mënyrë që të mos jetë më e ulët se çmimi më i lartë i paguar për aksionet e kësaj natyre. Rritja publikohet dhe i njoftohet menjëherë Autoritetit, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 21 të këtij ligji, dhe ka efekt për të gjithë mbajtësit e aksioneve dhe zbatohet pika 2 dhe 3 e nenit 19, të ligjit”

“1/2. Autoriteti me vendim mund të rregullojë çmimin lart ose poshtë, në rastet kur çmimi më i lartë është vendosur me marrëveshje midis blerësit dhe shitësit, kur çmimet e tregut të letrave janë manipuluar, kur çmimet e tregut në përgjithësi ose çmimet e caktuara janë ndikuar nga ngjarje të jashtëzakonshme, ose për të mundësuar shpëtimin e një firme në vështirësi. Në raste të tilla Autoriteti zbaton si kriter në përcaktimin e çmimit, vlerën mesatare të tregut gjatë një periudhe të caktuar, vlerën e ndarjes së kompanisë ose kritere të tjera objektive të vlerësimit të përdorura zakonisht në analizën financiare. Çdo vendim i Autoritetit për të rregulluar çmimin e drejtë duhet të argumentohet dhe të bëhet publik.

2. Në pikë 4, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “deri në përfundimin e periudhës së pranimit të ofertës.”

Neni 6

Në nenin 16, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “*në mbledhjen e thërritur me njoftim të shkurtër i cili nuk mbahet brenda dy javëve*”
2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve të thirrur për të vendosur mbi masat mbrojtëse sipas pikës 1 të këtij neni:

- a) nuk kanë efekt kufizimet mbi ushtrimin e të drejtës së votës të parashikuara në statutin e shoqërisë, objekt;*
 - b) nuk kanë efekt kufizimet mbi ushtrimin e të drejtës së votës të parashikuara në marrëveshje ndërmjet shoqërisë, objekt dhe mbajtësve të titujve të saj ose në marrëveshje ndërmjet vetë mbajtësve të titujve të saj, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;*
 - c) titujt/aksionet me të drejtë votimi të shumëfishtë llogariten me një votë secili.”*
3. Në pikën 2, shkronja “c”, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “*në çdo rast vijimi i zbatimit të vendimeve në fjalë duhet të konfirmohet nga Asambleja e përgjithshme*”

Neni 7

Në nenin 17, në pikën 1, shkronja “b”, pas togfjalëshit “*të kësaj pike*” shtohet togfjalëshi “*kufizimet e të drejtave të votës dhe aksionet me të drejtë të shumëfishtë bëjnë një votë secila*”.

Neni 8

Në nenin 29, pas pikës 4 shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

“5. Detyrimi për paraqitjen e ofertës së detyrueshme nuk zbatohet edhe kur ndaj shoqërisë, objekt të ofertës, ofertuesit ose personave që veprojnë në bashkëpunim me ta zbatohen instrumentet ose kompetencat e rezolucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme/rezolucionin në sektorin financiar. Kur masat e rezolucionit përfundojnë pa sjellë transferim përfundimtar të kontrollit, detyrimet e nenit 28 zbatohen sipas rastit.”

Neni 9

Në nenin 30, ndryshon si më poshtë:

“Neni 30

Kompetenca e Autoritetit

1. *Autoriteti është kompetent për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji në tërësi, në të gjitha rastet kur shoqëria objekt oferte ka selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji. Autoriteti është kompetent për mbikëqyrjen e:

- a. *zbatimit të dispozitave të nenit 35, të këtij ligji, nëse aksionet me të drejtë vote të një shoqërie aksionare me seli në Republikën e Shqipërisë, objekt i ofertës, janë listuar në tregun e rregulluar të një shteti tjetër anëtar të BE-së ose të një shteti të zonës ekonomike evropiane;*
 - b. *zbatimit të dispozitave të këtij ligji, për përmbajtjen dhe procedurën e ofertave, nëse shoqëria, objekt i ofertës, e ka selinë në një shtet tjetër anëtar të BE-së ose të zonës ekonomike evropiane, me kusht që të plotësohen rastet e parashikuara në nenin 36, pika 1 dhe 2.*
2. *Kur Autoriteti është kompetent për mbikëqyrjen e procedurës së marrjes, në rastin e përmendur në shkronjën b, të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti zbaton dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të dispozitave të parashikuara në nenin 35, në vend të tyre zbatohet ligji i Shtetit Anëtar në të cilin shoqëria objekt oferte ka selinë e saj.*
 3. *Në rast se dokumenti i ofertës është subjekt i miratimit paraprak nga një autoriteti mbikëqyrës të një shteti anëtar dhe është miratuar, ai do të njihet, pa pasur nevojë për miratimin e Autoritetit. Autoriteti mund të kërkoj informacion pranë autoritetit mbikëqyrës që ka miratuar ofertën në rastin kur ky informacion është specifik për tregun ku titujt e kompanisë së ofruar janë të pranuar për tregtim dhe lidhet me proceset që duhen respektuar për të pranuar ofertën dhe për të marrë dëmshpërblimin në mbyllje të ofertës, si dhe me rregullat tatimore që zbatohen për dëmshpërblimin e ofruar për mbajtësit e titujve.*
 4. *Autoriteti bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare që mbikëqyrin tregjet e kapitalit dhe shkëmbejnë informacion për zbatimin e rregullave të këtij ligji. Informacioni i shkëmbyer i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.*
 5. *Autoriteti, në rrethana të interesit publik ose të rasteve të jashtëzakonshme të tregut, që përfshijnë, fatkeqësi natyrore, kufizimit të lëvizjes sipas protokolleve shëndetësore, sulme kibernetike, prishje të infrastrukturës së tregut që pengojnë shpalljet brenda afateve, si dhe ristrukturime me vendime gjyqësore apo masa në kuadër të rezolucionit, me vendim të arsyetuar mund të bëjë përjashtime të kufizuara nga rregullat e këtij ligji, duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3, të këtij ligji.*
 6. *Autoriteti me rregullore miraton:*
 - a. *format e veprimit në mënyrë të përbashkët*
 - b. *llogaritjen e numrit dhe përqindjes së të drejtave të votës*
 - c. *sigurimit të shpërblimit*
 - d. *procedurat për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e të metave, që mund të lindin gjatë procedurës së ofertës për marrjen në kontroll.*
 - e. *procedurat për trajtimin e ankesave*
 - f. *çështje të tjera në zbatim të këtij ligji.”*

Neni 11

Neni 31 ndryshon si më poshtë:

“Neni 31

Ankimi

1. *Ankimi në rrugë gjyqësore ndaj akteve për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e të metave apo ndaj vendimeve të Autoritetit nuk ka efekt pezullues.*
2. *Gjykata, mund të refuzojë shqyrtimin e ankesave, përfshirë masat e përkohshme apo sigurimin e padisë, kur këto do të ndikonin në mënyrë të pajustificuar rezultatin, barazinë ndërmjet palëve ose kohëzgjatjen e ofertës.”*

Neni 12

Pas nenit 36, shtohet neni 36/1 dhe 36/2, me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 36/1

Raportimet të Komisionit Evropian

1. *Autoriteti është pika kombëtare e kontaktit dhe koordinon zbatimin e detyrimeve të raportimit ndaj Komisionit Evropian (“Komisioni”) në fushën e ofertave për marrje në kontroll.*
2. *Brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik, Autoriteti i përçjell Komisionit një raport për ofertat e marrjes në kontroll të përfunduara ose të ndërmarra gjatë vitit pararendës që lidhen me shoqëri, titujt e të cilave janë të pranuar në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë. Raporti përfshin, të paktën:*
 - a) *numrin e ofertave dhe rezultatin e secilës;*
 - b) *identifikimin e ofertuesit dhe të shoqërisë objekt;*
 - c) *çmimin e ofertës dhe përqindjen e kapitalit/votave të fituara;*
 - d) *masat mbrojtëse të marra nga administrimi i shoqërisë objekt dhe rezultatet e tyre;*
 - e) *ushtrimin e të drejtave nenit 25 dhe 26, nëse ka;*
 - f) *çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga udhëzimet e Komisionit ose nga aktet nënligjore vendase.*
3. *Autoriteti i njofton Komisionit për:*
 - a) *masat ligjore e nënligjore për sanksionet e zbatueshme për shkeljet e këtij ligji, si dhe çdo ndryshim të mëvonshëm;*
 - b) *çaktimin e autoritete kompetente dhe për çdo ndarje funksionesh mes tyre, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm;*
 - c) *tekstet e dispozitave kryesore të miratuara në fushën e këtij ligji, masat e rrepta dhe masat nga transpozimet, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm;*

Neni 36/2

ESAP dhe qasja e të dhënave

1. *Autoriteti depoziton informacionin përkatës pranë organit kompetent për mbledhjen e të dhënave, me qëllim që ky i fundit ta ngarkojë në Platformën e Vetme të Aksesit Evropian (ESAP).*
2. *Informacioni depozitohet në formate të lexueshme dhe të ripërdorshme, të shoqëruara me meta të dhëna standarde të identifikimit, si dhe tregues të tjerë sipas specifikimeve teknike, standardeve të metadatave, afateve dhe procedurave të depozitimit, si dhe rregullave për*

aksesin publik, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për krijimin dhe funksionimin e ESAP.”

Neni 13
Dispozita të fundit

Kudo në tekstin e ligjit togfjalëshi “*ligjin/t nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit*”

Neni 14

Aktet nënligjore

Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për nxjerrjen e aktit nënligjore sipas nenit 30, pika 6, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 1, pika 2, shkronja “b”, të nenit 30, pika 1, fjalia dytë, duke përfshirë shkronjat “a” dhe “b”, dhe të pikave 2, 3 dhe 4, nenit 36/1 dhe 36/2, të cilat hyjnë në fuqi në ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, fjalia e parë e pikës 1, të nenit 30, shfuqizohet.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI